




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

|                        |                                                                                                                 |               |                        |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|------------------------|
| DATE/A:                | 01.03.2018                                                                                                      | Dep. DPK      | Nr. Prot. 03-03/574/18 |
| REFERENC-Ë:            | AKK- DPKPP /03-03-566/18                                                                                        | Nr. l faq. 03 | Data 02-03-2018        |
| PËR/ZA/TO:             | z. Mehmet TINOVA,<br>Menaxher i Zyrës së Prokurimit - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A. (KMDK) |               |                        |
| CC:                    | z. Avdullah HAXHIU,<br>Kryeshef Ekzekutiv - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A. (KMDK)           |               |                        |
| NGA/OD/FROM:           | Shaip HAVOLLI,<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit                                                       |               |                        |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me tenderin me titull <b>“Trajtimi dhe largimi i ujërave të zeza në DS”</b>                      |               |                        |

**I nderuari z. TINOVA,**

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull **“Trajtimi dhe largimi i ujërave të zeza në DS”** me nr. të prokurimit: KMDK-18/643/221, nr. të brendshëm: 18/002/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull **“Trajtimi dhe largimi i ujërave të zeza në DS”** me nr. të prokurimit: KMDK-18/643/221, nr. të brendshëm: 18/002/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

## *Arsy etimi*

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 28 shkurt 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-566/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull **“Trajtimi dhe largimi i ujërave të zeza në DS”** me nr. të prokurimit: KMDK-18/643/221, nr. të brendshëm: 18/002/221, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A (KMDK).

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar Njoftimin për kontratë, Dosjen e Tenderit dhe pjesën e Specifikimeve teknike, ku në nenin IV.3.4), të njoftimit për kontratë është specifikuar, ***Vlera e sigurisë së tenderit 300 euro.***

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 57- Sigurimi i tenderit, të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të kërkoj sigurimin e tenderit, mirëpo nëse Autoriteti Kontraktues vendos një kërkesë të tillë atëherë siguria e tenderit nuk mund të jetë më pak se njëmijë (1.000) Euro.

Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se kërkesa e specifikuar në nenin IV.3.4 në njoftimin për kontratë, është në kundërshtim me nenin 57 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, si dhe me nenin 29 paragrafi 4 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, ku thuhet *“Nëse Autoriteti Kontraktues vendos që të detyrojë depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se një për qind (1%) dhe jo më shumë se tre për qind (3%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se njëmijë (1.000) Euro”*.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e tenderit, 57 paragrafi 3 Sigurimi i Tenderit, të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 29 paragrafi 4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull **“Trajtimi dhe largimi i ujërave të zeza në DS”** me nr. të prokurimit: KMDK-18/643/221, nr. të brendshëm: 18/002/221, ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*

